

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1019/3 Prot.

Tiranë, më 07.08 2017

VENDIM Nr. 172, datë 26.07.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje". Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10. të datës 26.07.2017. pasi shqyrtoi Kërkesën e ALUIZNI-it Vlorë për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit, shtesë anësore tre kate e Z. Petraq Nikolla Pici, Zona Kadastrale 8605, Lagjia "Osman Haxhiu", i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Vlorës.

VENDOSI:

1. Të miratojë Kërkesën e ALUIZNI-it Vlorë për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit, shtesë anësore tre kate e Z. Petraq Nikolla Pici, Zona Kadastrale 8605, Lagjia "Osman Haxhiu", i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Vlorës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria e KKA për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTER



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

